

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8 dhe neni 20 paragrafi 1 alineja 11 nga Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), neni 13 paragrafi 3 nga Ligji për mediet ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13 dhe 13/14) dhe neni 15

Paragrafi 1 alineja 7 dhe neni 39 paragrafi 1 alineja 11 nga Rregullorja për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr.01-4351/1 nga data 29.08.2014, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr.02-1466/8 nga data 27.02.2015, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në mbledhjen e shtatë të mbajtur më 27.02.2015, miratoi:

RREUGLLORE PËR MËNYRËN E PUBLIKIMIT E TË DHËNAVE PËR PUNËN E RADIODIFUZORËVE

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra se si radiodifuzerët janë të obliguar që në programin e tyre të publikojnë të dhënat për punën e tyre dhe incizim nga përmbajtja e publikuar të dorëzojnë edhe deri te Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Neni 2

Radiodifuzerët kanë obligim që të publikojnë të dhëna për:

- Strukturën pronësore, respektivisht të dhënat për emrin dhe selinë e personave juridik ose emrin dhe vendin dhe vendqëndrimin e personave fizik që janë pronarë të aksioneve ose pjesëve të publikuesi i mediumit, me të dhëna për përqindjen e aksioneve ose pjesën që e kanë fituar dhe datën e fitimit.
- redaktorit/redaktorëve përgjegjës dhe
- Burimeve të financimit të radiodifuzerit nga viti i kaluar (reklamata, sponsorimet, shitjet e përmbajtjeve, shërbimet e siguruara nga palë të treta etj.)

Neni 3

Të dhënat nga neni 2 i kësaj Rregullore, radiodifuzerët janë të obliguar që ti publikojnë në termin kryesor të programit të tyre, edhe atë:

- TV stacionet në nivel nacional para emetimit të lajmeve kryesore
- TV stacionet në nivel rajonal dhe lokal para emetimit të lajmeve kryesore ose të ndonjë emisioni tjetër që emetohet në termin kryesor dhe
- Radiostacionet në nivel nacional, rajonal dhe atë lokal në periudhën prej ora 15:00 deri në ora 16:00.

Neni 4

Radiodifuzerët janë të obliguar që të dhënat nga neni 2 i kësaj Rregullore ti publikojnë së paku tre herë gjatë vitit, edhe atë:

- Hera e parë më së voni deri më 31 mars,
- Hera e dytë më së voni deri më 30 qershor dhe
- Hera e tretë më së voni deri më 31 tetor.

Neni 5

Radiodifuzerët janë të obliguar që në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të të dhënave, të dorëzojnë incizim deri te Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele nga përmbajtja e publikuar si argument se e kanë plotësuar obligimin.

Neni 6

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e publikimit në "Gazetë zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

**Nr. 01-1567/1
mediatike
audio dhe audiovizuele
Shkup**

Agjencia për shërbime

Kryetar i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v